



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E
PËRGJITHSHME

MINISTRIA E
BRENDSHME

MINISTRIA E
FINANCEVE

SHËRBIMI INFORMATIV
SHTETËROR

Nr. 1366 Prot.

Nr. 3521 Prot.

Nr. 5083 Prot.

Nr. 324 Prot.

INSPEKTORATI I LARTË I
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE

KONTROLLI I LARTË I
SHTETIT

Nr. 1510 Prot.

Nr. 232 Prot.

Tiranë, më 6 Maj 2009

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Me synimin për të rritur cilësinë e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit;

Me synimin për të rritur numrin e rasteve të ngritjes së akuzës dhe dërgimit në gjykatë të autorëve të këtyre veprave penale;

Me synimin për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin institucional ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligj për të realizuar këto detyra;

Bazuar në eksperiencën pozitive dhe arritjet e Njësisë së Përbashkët Hetimore të ngritur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Memorandumin e datës 22 Maj 2007;

Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Bien dakord për:

1. Krijimin e gjashtë Njësive të Përbashkëta Hetimore të reja, në përbërje të strukturës së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë.
2. Kompetencat dhe veprimtaria e Njësive të Përbashkëta Hetimore në përbërje të strukturës së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë do të ushtrohen nga data 6 Maj 2009, bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe në këtë Memorandum.
3. Kompetencat dhe veprimtaria e Njesisë së Përbashkët Hetimore të ngritur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të vazhdojnë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe këtë Memorandum.

Për të realizuar sa më sipër, palët nënshkruese shprehin angazhimin për të ndërmarrë masat e mëposhtme:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

1. Deri më datë 6 maj 2009, Prokurori i Përgjithshëm do të emërojë nga një prokuror në krye të secilës prej gjashtë Njësive të Përbashkëta Hetimore të reja. Prokurorët e emëruar si drejtues duhet të kenë përvojë në ndjekjen penale të rasteve të krimit ekonomik dhe korrupsionit.
2. Deri më datë 30 shtator 2009, Prokurori i Përgjithshëm do të emërojë pranë secilës nga Njësitet e Përbashkëta Hetimore të reja prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, si dhe do të ruajë numrin e personelit të Njesisë së Përbashkët Hetimore Tiranë. Për aq sa është e mundur, prokurorët duhet të kenë hetuar raste të krimit ekonomik dhe korrupsionit e te kenë studiuar për financë ose biznes, si dhe oficerët e policisë gjyqësore të kenë përvojë në fushën e financave. Numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore sipas prokurorive do të jetë sipas tabelës së mëposhtme. Në këtë numër nuk përfshihen drejtuesit e secilës njësi:

Prokuroria	Nr. i Prokurorëve	Nr. i Oficerëve të Policisë Gjyqësore
Tiranë	8	8
Durrës	3	3
Vlorë	2	2
Fier	2	2
Shkodër	3	3
Korçë	2	2
Gjirokastrë	2	2

3. Deri me datë 30 shtator 2009, Prokurori i Përgjithshëm do të caktojë në secilën Prokurori të Apelit nga një prokuror, i cili do të ndjekë gjatë gjykimit në Apel çështjet penale që do të ndiqen në shkallë të parë nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore.
4. Deri me datë 6 maj 2009, Prokurori i Përgjithshëm do të caktojë një prokuror si drejtues të Sektorit kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, deri më datë 30 shtator 2009, do të caktojë të paktën dy prokurorë të tjerë në këtë sektor. Të gjithë këta prokurorë duhet të kenë përvojë dhe njohuri të mira në hetimin e krimit financiar dhe ekonomik.
5. Sektori do të komunikojë rregullisht me të gjithë prokurorët e Njësive të Përbashkëta Hetimore, si dhe me prokurorët e Prokurorive të Apelit, për të hartuar strategji dhe lehtësuar komunikimin. Sektori do të mbikëqyrë të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore në lidhje me procedimet për veprat penale të renditura në këtë Memorandum dhe, nëse do ta çmojë të arsyeshme, do të rekomandojë që prokurorë të Njësive të Përbashkëta Hetimore të caktohen për të hetuar çështje të rretheve të tjera gjyqësore. Sektori do të punojë për të krijuar një sistem, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, me anë të cilit të vendosen metodat e duhura për monitorimin e ecurisë së Njësive të Përbashkëta Hetimore.
6. Sektori do të realizojë lidhjet, komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve me Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, në kuadër të zbatimit të këtij Memorandumi.
7. Në rastet kur Prokuroria e Përgjithshme do të fillojë procedime penale për subjekte kompetencë e saj dhe për veprat penale të parashi kuara në këtë Memorandum, do të krijohet një Njësi e Përbashkët Hetimi "Ad Hoc" në Prokurorinë e Përgjithshme. Në këto raste palët nënshkruese të këtij Memorandumi marrin përsipër të caktojnë pranë kësaj njësie oficerë të policisë gjyqësore të fushave përkatëse.

MINISTRIA E BRENDSHME

8. Deri më datë 30 Shtator 2009, Ministri i Brendshëm do të emërojë pranë secilës nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore të reja oficerë të policisë gjyqësore, si dhe do të ruajë numrin e personelit të Njësive të Përbashkët Hetimore të Tiranës. Për aq sa është e mundur, këta oficerë të policisë

gjqësore duhet të kenë hetuar raste të krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe të kenë studiuar për financë ose biznes. Numri i oficerëve të policisë gjyqësore sipas prokurorive do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Prokuroria	Nr. i Oficerëve të Policisë Gjyqësore
Tirana	10
Durrës	4
Vlorë	3
Fier	3
Shkodër	4
Korcë	3
Gjirokastrë	3

9. Drejtoria kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë do të jetë në rolin e ndërlidhësit të posacëm të Ministrit të Brendshëm me të gjitha Njësitë e Përbashkëta Hetimore, si dhe me të gjithë institucionet nënshkruese, në kuadër të zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë Memorandum.

MINISTRIA E FINANCAVE

10. Ministri i Financave do të caktojë 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Analizës dhe Teknologjisë së Informacionit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Hetimit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dhe 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (anti-korrupsioni) në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të cilët do të shërbejnë si ndërlidhës të posacëm me të gjitha Njësitë e Përbashkëta Hetimore, si dhe me të gjithë institucionet nënshkruese, në kuadër të zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë Memorandum.
11. Deri më datë 30 shtator 2009, Ministri i Financave do të caktojë oficerë të policisë gjyqësore nga Drejtoria e Hetimit Tatimor e Drejtorisë e Përgjithshme e Tatimeve dhe nga Departamenti Operativ– Hetimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave tek Njësitë e Përbashkëta Hetimore të reja, si dhe do të ruajë numrin e personelit të Njësisë së Përbashkët Hetimore të Tiranës, sipas numrave të mëposhtëm. Për aq sa është e mundur, këta oficerë duhet të kenë kryer kontrole apo hetime të ndërlikuara.

Prokuroria	Nr. i oficerëve të Policisë Gjyqësore të Tatimeve	Nr. i oficerëve të Policisë Gjyqësore të Doganave
Tirana	3	3
Durrës	1	1
Vlorë	1	1
Fier	1	0
Shkodër	1	1
Korcë	1	1
Gjirokastrë	1	1

SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR

12. Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror do të caktojë 1 (një) inspektor me eksperiencë nga Drejtoria kundër Terrorit, Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, i cili do të shërbejë si ndërlidhës i posaçëm me të gjithë institucionet nënshkruese, në kuadër të zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë Memorandum.
13. Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror do të caktojë 6 (gjashtë) ndërlidhës të posaçëm, nga një pranë secilës Njësiti të Përbashkët Hetimore të re, si dhe do të ruajë 2 (dy) inspektorët që tashmë janë të caktuar si ndërlidhës të posaçëm pranë Njesisë së Përbashkët Hetimore të Tiranës. Për aq sa është e mundur, këta inspektorë duhet të kenë eksperiencë në mbledhjen e informacionit mbi korrupsionin e krimin ekonomik e financiar dhe të kenë studiuar për financë ose biznes.

INSPEKTORIATI I LARTË I DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE

14. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) do të caktojë 1 (një) inspektor me përvojë si ndërlidhës të posaçëm për të gjitha Njësitë e Përbashkëta Hetimore. Për aq sa është e mundur, ky inspektor duhet të ketë eksperiencë në mbledhjen e informacionit mbi korrupsionin e krimin ekonomik e financiar dhe të ketë studiuar për financë ose biznes.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

15. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) do të caktojë 1 (një) kontrollor me përvojë si ndërlidhës të posaçëm për të gjitha Njësitë e Përbashkëta Hetimore. Për aq sa është e mundur, ky kontrollor duhet të ketë eksperiencë

në mbledhjen e informacionit mbi korrupsionin e krimin ekonomik e financiar dhe të kenë studiuar për financë ose biznes.

ANGAZHIME TË PËRBASHKËTA NË LIDHJE ME PERSONELIN

16. Personat e emëruar në të gjitha Njësitë e Përbashkëta Hetimore nga ana e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave do të përbëjnë shërbime të policisë gjyqësore në kuptim të nenit 6 të Ligjit Nr. 8677, datë 2.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".
17. Përparësi në emërimin në të gjitha Njësitë e reja të Përbashkëta Hetimore do t'u jepen atyre individëve të cilët kanë marrë pjesë në kurse kualifikimi specifike për hetimin dhe ngritjen e akuzës për rastet e krimin ekonomik dhe korrupsionit, si dhe kanë kryer hetime të sukseshme për veprat penale të renditura në këtë Memorandum.
18. Individët, të cilët do të emërohen si anëtarë të të gjitha Njësive e Përbashkëta Hetimore apo do të caktohen si ndërlidhës të posacëm të tyre, do të verifikohen me kujdes, në bashkëpunim me Shërbimin Informativ Shtetëror, për t'u siguruar që kanë integritet të lartë moral e profesional. Individët që nuk arrijnë të kalojnë procesin e verifikimit nuk do të emërohen anëtarë të Njësitë e Përbashkëta Hetimore.
19. Individët e emëruar në Njësitë e Përbashkëta Hetimore do të vazhdojnë të trajtohen financiarisht nga institucionet prej të cilëve janë emëruar.
20. Asnjërit prej individëve të emëruar në ndonjë Njësi të Përbashkët Hetimore, në cilësinë e oficerit të shërbimeve të policisë gjyqësore, nuk do t'i ulet grada apo pagesa për shkak të këtij emërimi.
21. Prokurori i Përgjithshëm merr përsipër pajisjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të Njësive të Përbashkëta Hetimore me zyra, pajisje kompjuterike dhe personelin e nevojshëm administrativ në shërbim të tyre.
22. Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave marrin përsipër të pajisin, në të njëjtën mënyrë, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve përkatëse.
23. Palët nënshkruese të këtij memorandumi, marrin përsipër të planifikojnë fonde për projekt-buxhetet e vitit 2010 dhe viteve në vazhdim për sigurimin e mjeteve teknike të nevojshme që Njësitë e Përbashkëta Hetimore të mund të përmbushin detyrat e tyre.

24. Në varësi të vështirësisë së çështjeve dhe të arritjeve të Njësive të Përbashkëta Hetimore, Drejtuesi i secilës Njësi mund t'i propozojë Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit dhënien e shpërblimeve për anëtarët e Njësive të Përbashkëta Hetimore.
25. Në qoftë se do të jetë e nevojshme të rritet numri i anëtarëve të Njësive të Përbashkëta Hetimore, drejtuesit e tyre mund t'i propozojnë Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror emërimin e personelit shtesë në këto Njësi të Përbashkëta Hetimore.
26. Çdo fund viti, Drejtuesi i secilës Njësi të Përbashkët Hetimore përgatit një vlerësim me shkrim për çdo anëtar të saj, duke përfshirë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Vlerësimi u dërgohet palëve nënshkruese të këtij Memorandumi. Ky vlerësim nuk paragjykon procedurat e vlerësimit profesional sipas ligjeve përkatëse.
27. Masat disiplinore dhe rastet e transferimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Njësive të Përbashkëta Hetimore merren sipas procedurave të parashikuara në ligjet përkatëse. Drejtuesi i secilës nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore caktohet Kryetar i Komisionit të Disiplinës, në rastet e parashikuara nga neni 15 i Ligjit Nr. 8677, datë 2.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

VEPRAT PENALE

28. Njësitë e Përbashkëta Hetimore në Prokurorinë e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Korcës, Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës do të kenë kompetencë lëndore për hetimin e veprave penale të mëposhtme:

- 1) Neni 135 – Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën;
- 2) Neni 143/a – Skemat mashtruese dhe piramidale;
- 3) Neni 143/b – Mashtrimi kompjuterik;
- 4) Neni 146 – Mashtrimi në kredi;
- 5) Nenet 171 deri 177 dhe neni 179/a - Krimet në fushën e doganave, me përshtimi të kontrabandës me vlerë të vogël, sipas përcaktimit që do të bëjë Prokurori i Përgjithshëm;
- 6) Nenet 180 deri 182 – Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet;
- 7) Nenet 183 deri 185 – Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë;
- 8) Neni 186, paragrafi 3 – Falsifikimi i dokumenteve nga personi që ka për detyrë leshimin e tyre;

- 9) Neni 186/a – Falsifikimi kompjuterik;
- 10) Neni 192/b – Hyrja e paautorizuar kompjuterike;
- 11) Nenet 193 deri 196 - Veprat penale në fushën e falimentimit;
- 12) Neni 197/a – Paracaktimi i rezultatit në garat sportive;
- 13) Neni 197/b – Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive;
- 14) Neni 230/c – Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit;
- 15) Neni 230/ç – Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur;
- 16) Neni 230/d – Grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit;
- 17) Neni 244 – Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- 18) Neni 245 – Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;
- 19) Neni 245/1 – Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike;
- 20) Neni 248 – Shpërdorimi i detyrës;
- 21) Neni 256 – Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti;
- 22) Neni 257 – Përfitimi i paligjshëm i interesave;
- 23) Neni 257/a – Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike;
- 24) Neni 258 – Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike;
- 25) Neni 259 – Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- 26) Neni 260 – Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë;
- 27) Neni 287 – Pastrimi i produkteve të vepres penale;
- 28) Neni 293/a – Përfitimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike;
- 29) Neni 293/b – Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike;
- 30) Neni 293/c – Ndërhyrja në sistemet kompjuterike;
- 31) Neni 293/ç – Keqpërdorimi i pajisjeve;
- 32) Neni 312 – Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;
- 33) Neni 319 – Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- 34) Neni 319/a – Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- 35) Neni 328 – Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve.

29. Kur gjatë hetimit të veprave penale të parashikuara në këtë Memorandum, rezultojnë dyshime të arsyeshme se të pandehurit kanë kryer vepra penale të tjera, Njësitë e Përbashkëta Hetimore do të kenë kompetencën të vazhdojnë

hetimin dhe të ngrenë akuzën edhe për këto vepra penale, duke zbatuar dispozitat e neneve 79, paragrafi 1, shkronja "b" dhe 82 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet e procedimeve të lidhura, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 306 të këtij Kodi.

30. Në Prokuroritë ku do funksionojnë Njësitë e Përbashkëta Hetimore, në rastet që gjatë hetimit të veprave penale të tjera, të paparashikuara në këtë Memorandum, konstatohen elementë të veprave penale të parashikuara në këtë Memorandum, atëherë hetimet e këtyre çështjeve kalojnë tek prokurorët e Njësitë e Përbashkëta Hetimore përkatëse.
31. Njësitë e Përbashkëta Hetimore do të kenë gjithashtu kompetencën për të hetuar vepra të tjera penale që do gjykohen si të rëndësishme nga Prokurori i Përgjithshëm, brenda territorit ku ushtrojnë kompetencat e tyre.
32. Prokurorët e Njësive të Përbashkëta Hetimore mund të komandohen nga Prokurori i Përgjithshëm për të ushtruar ndjekjen penale në prokurori të tjera, për veprat penale të parashikuara në këtë Memorandum.
33. Duke filluar nga 30 shtatori 2009, të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal e të renditura në këtë Memorandum, do të hetohen nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore të reja. Procedimet e regjistruara përpara datës 30 shtator 2009 do të vazhdojnë të ndiqen deri në përfundim të gjykimit nga prokurorët që i kanë patur këto çështje në ngarkim që në fillim.

RAPORTIMI

34. Drejtuesi i secilës Njësi të Përbashkët Hetimore, i ndihmuar nga Kancelari dhe Zyra e Regjistrimit, përgatit raporte statistikore tremujore dhe vjetore. Ai përgjigjet për informimin çdo muaj të Sektori kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Përgjithshme mbi të dhënat e çështjeve në hetim dhe gjykim. Raportimi bëhet sipas formularëve të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm.
35. Prokurorët dhe oficerët e Njësive të Përbashkëta Hetimore do të takohen periodikisht për diskutime dhe analiza të rasteve të vështira me prokurorët përkatës në Prokurorinë e Përgjithshme.
36. Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, mund të kërkojnë nga oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve, anëtarë të Njësive të Përbashkëta Hetimore, informacione lidhur me ecurinë e procedimeve të caktuara. Nuk lejohet informimi për fakte që përbëjnë sekret hetimor, sipas nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk do

të ketë kufizime informimi për çështje që ndodhen në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

37. Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të takohen çdo gjashtë muaj për të vlerësuar progresin dhe arritjet e punës së Njësive të Përbashkëta Hetimore.

38. Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, marrin përsipër të bashkërendojnë punën dhe të nxjerrin të gjitha aktet e nevojshme nënligjore për vënien në zbatim të këtij Memorandumi.

39. Ky memorandum hyn në fuqi menjëherë.


Prokurori i Përgjithshëm


Ina RAMA




Ministri i Brendshëm


Bujar NISHANI



Ministri i Financave


Ridvan BODE



Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror


Bahri SHAQIRI



Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP


Adriatik LLALLA



Kryetar i KLSH


Robert ÇEKU

